



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.132, datë 13.03.2024

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR.24 DATË 18.01.2023, PËR KANDIDATIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e z. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.24 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 20, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me vendimin nr.23 dhe nr. 24 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 20, nr. 23 dhe nr.24, datë 18.01.2023 (më poshtë referuar si vendimi 20/2023, 23/2023 dhe 24/2023), kandidoi edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht

i transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Në pozicionet nr. 20 dhe nr. 24 që i referohen lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës ka kandidatë të kualifikuar me 2(dy) vlerësime dhe procedura ka vijuar me caktimin e relatorit të përzgjedhjes për këto pozicione.

5. Në kushtet kur në pozicionin nr. 23 nuk ka kandidatë të kualifikuar me dy vlerësime, këshilli me vendimin nr. 295, datë 30.05.2023 ka vendosur: *“Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.*

2. *Caktimin e relatorit si më poshtë: 4. Për kandidatin z. {...}- relator z. Klodian Kurushi.*

6. Më datë 01.06.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të përmendur më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 332, datë 21.06.2023, ka vendosur:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në vijim Këshilli, në kushtet kur në pozicionin nr. 24 nuk ka kandidatë të kualifikuar me dy vlerësime, me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë

ose mund të kenë 1 (një) vlerësim. Në pikë 3 (tre) të tij ka vendosur “Për kandidatët znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore që ka përfunduar për këtë kandidatim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimet nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

10. Ndërkohë, me Vendim nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 21, nr. 24, nr. 19 dhe nr. 18 u caktua anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro.

11. Më datë 28.09.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për vendimit nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

12. Më datë 29.02.2024 kandidati z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 24 datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke paraqitur se: *omissis ...* “ Me janar 2023 kam aplikuar për lëvizje paralele për tri vende të lira, përfshirë ato të shpallura me vendimet nr. 23, date 18.01.2023 dhe nr. 24, date 18.01.2023, të KLGJ-se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (sot "Gjykata e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës"). Me vendimin nr. 332, date 21.06.2023, të KLGJ-se, jam kualifikuar për vijimin e procedurave për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për vendin e lire të shpallur me vendimin nr. 23, date 18.01.2023, të KLGJ-se. Nga ana tjetër, ende nuk ka një vendimmarrje në lidhje me mua, sa i takon vendit të lire të shpallur me vendimin nr. 24, date 18.01.2023, të KLGJ-se. Në kushtet kur ne ditët në vijim (deri me date 01.03.2024) do të aplikoj për lëvizje paralele edhe për dy vendet e lira pranë të njëjtës gjykate, në fushën penale, të shpallura me vendimet nr. 85, date 20.02.2024 dhe 86, date 20.02.2024, të KLGJ-se, me qëllim zbatimin e kërkesave të ligjit, për të mos kandiduar në më shumë se tri pozicione të lira në proces, me ane të këtij e-mail-i heq dorë nga aplikimi për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkalles së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Durrës, ne vendin e lire te se drejtës civile, te shpallur me vendimin nr. 24, date 18.01.2023, te Këshillit te Larte Gjyqësor.”... omissis.

13. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të Vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ku përcaktohet se: *“Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”*; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”*

14. Në Mbledhjen e datës 29.02.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurën e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 24 datë 18.01.2023, bazuar në pikën 107, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit nr. 320/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure lëvizjeje paralele për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

16. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në*

procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

17. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun VI, Seksioni D, pika 107, të tij, përcaktohet se: *“Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”.* Gjithashtu është mbajtur në konsideratë dhe pika 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”*

18. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga procedura e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 24 datë 18.01.2023. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve të tjera ligjore për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i tij për t’u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

19. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 24 datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për këtë kandidat.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR